UDHËZIM
Nr.1, datë 19.2.2010

PËR LEJIMIN E DISA KATEGORIVE TË TRANSFERIMEVE NDËRKOMBËTARE TË TË DHËNAVE PERSONALE NË NJË SHTET QË NUK KA NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Mbështetur në pikën 3 të nenit 9 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.934, datë 2.9.2009 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

1. Lejohet transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, në një shtet tjetër, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, kur:

a) subjekti i të dhënave personale jep pëlqimin e tij të shprehur për transferimin ndërkombëtar të të dhënave të tij. Për të dhënat sensitive, pëlqimi duhet të jetë i qartë dhe i shprehur;

b) transferimi ndërkombëtar i të dhënave është i nevojshëm për lidhjen ose përmbushjen e një kontrate në interesin e subjektit të të dhënave;

c) transferimi ndërkombëtar i të dhënave është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;

ç) transferimi ndërkombëtar i të dhënave është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave. Interesi jetësor ka të bëjë me informacione mjekësore të subjektit të të dhënave në rastin e një urgjence mjekësore, trajtimin mjekësor ose çdo përkujdesje mjekësore të nevojshme që duhet t'i jepet subjektit. Transferimi nuk mund të bëhet për çdo arsye tjetër, e cila nuk lidhet drejtpërdrejt me subjektin e të dhënave (p.sh. nuk lejohet të bëhet për interes të kërkimeve mjekësore, statistikave etj.);

d) transferimi ndërkombëtar bëhet nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi;

dh) transferimi ndërkombëtar autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;

e) transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale është detyrim ligjor i kontrolluesit dhe parashikohet shprehimisht në nenet 8, 9, 24 e 31 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

2. Në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij udhëzimi, lejohet transferimi ndërkombëtar i një kategorie të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale kur kontrolluesi paraqet mbrojtje të përshtatshme të privatësisë, të drejtave themelore dhe lirive të individëve në bazë të klauzolave kontraktuale standarde sipas shtojcës dhe anekseve bashkëlidhur këtij udhëzimi, të cilat janë pjesë e tij.

3. Parashikuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Flora Çabej (Pogaçe)

SHTOJCA

KLAUZOLAT KONTRAKTUALE STANDARDE PËR TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA SHQIPËRIA DREJT VENDEVE TË TRETA

Marrëveshje për transferimin e të dhënave ndërmjet

_____(emri)

_____(adresa dhe vendi i vendosjes)

Tani e tutje "eksportuesi i të dhënave" dhe

_____(emri)

_____(adresa dhe vendi i vendosjes)

Tani e tutje "importuesi i të dhënave"

Secili një "palë"; së bashku "palët".

Përkufizime

Për qëllime të klauzolave:

a) "të dhëna personale", "kategoritë e veçanta të të dhënave/të dhëna sensitive", "përpunim", "kontrollues", "përpunues", "subjekt i të dhënave" dhe "autoritet mbikëqyrës/autoritet", do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

(ku "autoritet" do të thotë autoriteti kompetent për mbrojtjen e të dhënave në territorin e të cilit është vendosur eksportuesi i të dhënave);

b) "eksportues i të dhënave" do të thotë kontrollues që transferon të dhënat personale;

c) "importuesi i të dhënave" do të thotë kontrollues, i cili pranon të marrë nga eksportuesi të dhëna personale për përpunim të mëtejshëm, në përputhje me klauzolat e këtyre neneve dhe që nuk është subjekt i sistemit të një vendi të tretë që siguron mbrojtje të përshtatshme;

ç) "klauzola" janë dispozita kontraktuale, të cilat janë një dokument i lirë që nuk përfshin kushte komerciale të biznesit, të themeluar nga palët sipas marrëveshjeve të veçanta komerciale.

Detajet e transferimit (si dhe të dhënat personale të mbuluara) janë të specifikuara në aneksin B, i cili formon një pjesë integrale të klauzolave.

I. Detyrimet e eksportuesit të të dhënave

Eksportuesi i të dhënave duhet të sigurojë dhe të marrë përsipër se:

a) Të dhënat personale janë grumbulluar, përpunuar dhe transferohen në përputhje me ligjet e zbatueshme për eksportuesin e të dhënave.

b) Ai është përpjekur për të përcaktuar që importuesi i të dhënave është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ligjore sipas këtyre dispozitave.

c) Ai do t'i sigurojë importuesit të të dhënave, kur kërkohet, kopje të ligjeve përkatëse për mbrojtjen e të dhënave ose referenca të tyre (ku është e përshtatshme, dhe jo duke përfshirë këshilla ligjore) dhe të vendit ku është vendosur eksportuesi i të dhënave.

ç) Ai do t'i përgjigjet në një afat të arsyeshëm kërkesave të autoritetit kontrollues në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga importuesi i të dhënave dhe çdo kërkese nga subjektet e të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave nga importuesi i të dhënave.

d) Ai do të vërë në dispozicion të subjekteve të të dhënave, sipas kërkesës, një kopje të pikave që ndodhen në këtë aneks, me përjashtim të shtojcës II, e cila mund të zëvendësohet nga një përshkrim i përmbledhur i masave të sigurisë.

Kur informacioni është hequr, eksportuesi i të dhënave do të informojë subjektet e të

dhënave me shkrim për arsyet e heqjes dhe të drejtën e tyre për të tërhequr vëmendjen e autoritetit. Megjithatë, eksportuesi i të dhënave duhet të pranojë një vendim të autoritetit në lidhje me aksesin e plotë të neneve nga subjektet e të dhënave, për aq kohë sa subjektet e të dhënave kanë rënë dakord të respektojnë konfidencialitetin e informacionit konfidencial të hequr. Eksportuesi i të dhënave, gjithashtu, do të sigurojë një kopje të klauzolave të autoritetit kur kërkohet.

II. Detyrimet e importuesit të të dhënave

Importuesi i të dhënave duhet të sigurojë dhe të marrë përsipër se:

a) Ai do të ndërmarrë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm ose humbja aksidentale, ndryshimet, përhapja e paautorizuar ose aksesi, të cilat sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme nga rreziku i përpunimit dhe natyra e të dhënave të mbrojtura.

b) Ai do të ketë procedura, në mënyrë që çdo palë e tretë, të cilën ai e autorizon të ketë akses në të dhënat personale, duke përfshirë përpunuesit, do të respektojë dhe të ruajë konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale. Çdo person që vepron nën autoritetin e importuesit të të dhënave, duke përfshirë dhe përpunuesin e të dhënave, do të jetë i detyruar t'i përpunojë të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të importuesit të të dhënave. Kjo dispozitë nuk zbatohet për personat e autorizuar ose të kërkuar nga ligji ose rregullorja për të pasur akses në të dhënat personale.

c) Ai nuk ka asnjë arsye për të besuar, në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, në ekzistencën e çdo ligji lokal që do të ketë një efekt të konsiderueshëm negativ mbi garancitë e parashikuara në këto dispozita, dhe ai do të informojë eksportuesin e të dhënave (i cili do t'i kalojë njoftimin autoritetit kur kërkohet), në qoftë se ai vjen në dijeni për ligje të tilla.

ç) Ai do të përpunojë të dhënat personale për qëllimet e përshkruara në aneksin B, dhe ka autoritetin ligjor për të dhënë garancitë dhe për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këto dispozita.

d) Ai do t'i caktojë eksportuesit të të dhënave një pikë kontakti brenda organizatës së tij të autorizuar për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, dhe do të bashkëpunojë në mirëbesim me eksportuesin e të dhënave, subjektet e të dhënave dhe autoritetin, lidhur me të gjitha kërkesat, brenda një afati të arsyeshëm. Kështu, importuesi i të dhënave do të marrë përgjegjësi për respektimin e parashikimit të klauzolës I (d).

dh) Me kërkesë të eksportuesit të të dhënave, ai do t'i sigurojë eksportuesit të të dhënave dëshmi për burimet financiare të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas klauzolës III (të cilat mund të përfshijnë sigurimin e mbulimit).

e) Me kërkesë të arsyetuar të eksportuesit të të dhënave, ai do të paraqesë lehtësitë e përpunimit të të dhënave, të dhënat e arkivuara dhe dokumentacionin e nevojshëm për rishikimin e përpunimit, auditimin dhe/ose certifikimin nga eksportuesi i të dhënave për të konstatuar pajtueshmëritë me garancitë dhe detyrimet e ndërmarra në këto dispozita, me njoftim të arsyeshëm dhe gjatë orarit të rregullt të biznesit. Kërkesa do të jetë subjekt i ndonjë pëlqimi ose miratimi të nevojshëm nga një autoritet rregullator ose mbikëqyrës brenda vendit të importuesit të të dhënave, pëlqimin ose miratimin e të cilit importuesi i të dhënave do të përpiqet ta marrë në kohën e duhur.

ë) Ai do të përpunojë të dhënat personale, në përputhje me:

1. ligjet e mbrojtjes së të dhënave të vendit në të cilin është themeluar eksportuesi i të dhënave; ose

2. dispozitat përkatëse (1) të ndonjë vendimi të Komisionit në pajtim me nenin 25 (6) të direktivës 95/46/EC, ku importuesi i të dhënave përputhet me dispozitat përkatëse të një autorizimi ose vendimi të tillë dhe është bazuar në një vend në të cilin një autorizim ose vendim i tillë i përket, por nuk është i mbuluar nga autorizime ose vendime të tilla për qëllimet e transferimit të të dhënave personale; ose

3. parimet e përpunimit të të dhënave të përcaktuara në aneksin A.

Importuesit të të dhënave për të treguar se cilin opsion ai zgjedh: _____

Inicialet e importuesit të të dhënave: _____

f) Ai nuk do të publikojë ose transferojë të dhënat personale të një kontrolluesi, i cili ndodhet jashtë Zonës Ekonomike Europiane (EEA), nëse nuk njofton eksportuesin e të dhënave në lidhje me transferimin; dhe:

1. kontrolluesve të të dhënave personale si palë e tretë, që përpunojnë të dhëna personale në përputhje me një vendim të Komisionit kur një vend i tretë ofron mbrojtjen e duhur; ose

2. kontrolluesi i të dhënave personale si palë e tretë, bëhet nënshkrues i këtyre klauzolave ose një marrëveshjeje tjetër të transferimit të të dhënave, miratuar nga një autoritet kompetent në BE; ose

3. subjekteve të të dhënave u janë dhënë mundësitë për të kundërshtuar, pasi kanë qenë të informuar për qëllimet e transferimit, kategoritë e marrësve dhe faktin se vendet, të cilat u janë eksportuar të dhënat mund të kenë standardet e mbrojtjes së të dhënave të ndryshme; ose

4. në lidhje me transfertat e mëtejshme të të dhënave sensitive, subjektet e të dhënave e kanë dhënë pëlqimin e tyre të qartë për transferimin e mëtejshëm.

III. Përgjegjësia dhe të drejtat e palës së tretë

a) Çdo palë do të jetë përgjegjëse ndaj palëve të tjera për dëmet që ju shkaktohen nga shkelja e këtyre neneve. Përgjegjësia midis palëve është e kufizuar për dëmin aktual të pësuar. Dëmet me karakter ndëshkues (p.sh. dëmet që kanë për qëllim ndëshkimin e një pale për sjelljen e saj fyese) janë të përjashtuara specifikisht. Çdo palë do të jetë përgjegjëse për dëmet që i shkakton subjekteve të të dhënave nga çfarëdo shkelje e të drejtave të palës së tretë në këto dispozita. Kjo nuk ndikon në detyrimin e eksportuesit të të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave të tij.

b) Palët pajtohen që një subjekt i të dhënave do të ketë të drejtë të zbatojë si palë e tretë përfituese këtë nen dhe klauzolat I (b), I (ç), I (d), II (a), II (c), II (ç), II (ë), II (f), III (a), V, VI (ç) dhe VII kundër importuesit të të dhënave apo eksportuesit të të dhënave, për shkelje të detyrimeve të tyre kontraktuale përkatëse, në lidhje me të dhënat e tij personale, dhe të pranojnë juridiksionin për këtë qëllim në vendin e themelimit të eksportuesit të të dhënave. Në rastet e pretendimeve për shkelje nga importuesit e të dhënave, subjekti i të dhënave duhet, së pari t'i kërkojë eksportuesit të të dhënave që të marrë masat e duhura për të zbatuar të drejtat e tij kundër importuesit të të dhënave, dhe nëse eksportuesi i të dhënave nuk ndërmerr një veprim të tillë brenda një afati të caktuar (e cila në rrethana normale do të ishte një muaj), subjekti i të dhënave mund të zbatojë direkt të drejtat e tij kundër importuesit të të dhënave. Një subjekt i të dhënave ka të drejtë të procedojë drejtpërsëdrejti kundër një eksportuesi të të dhënave që ka dështuar në përpjekjet e tij për të përcaktuar që importuesi i të dhënave është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ligjore sipas këtyre klauzolave (eksportuesit e të dhënave duhet të kenë barrën për të provuar se ai mori masat e nevojshme).

IV. Ligji i aplikueshëm për klauzolat

Këto dispozita do të drejtohen nga ligji i vendit në të cilin eksportuesi i të dhënave është vendosur, me përjashtim të ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga importuesi i të dhënave në pikën II (ë), të cilat do të zbatohen vetëm nëse është zgjedhur kështu nga importuesi i të dhëna nën këtë klauzolë.

V. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me subjektet e të dhënave ose autoriteti

a) Në rast të një mosmarrëveshje ose pretendimi të bërë nga një subjekt i të dhënave ose autoritet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale kundër ose të dyja palëve, palët do të informojnë njëra-tjetrën për çdo mosmarrëveshje ose kërkesë, dhe do të bashkëpunojnë me synimin për zgjidhjen e tyre në mënyrë miqësore dhe në kohën e duhur.

b) Palët bien dakord që t'i përgjigjen çdo procedure ndërmjetësimi jodetyruese të

disponueshme, të nisur nga një subjekt i të dhënave ose nga një autoritet. Nëse ata nuk marrin pjesë në procedurë, palët duhet të njoftojnë (si me anë të telefonit apo mjeteve të tjera elektronike). Palët, gjithashtu, bien dakord që të marrin pjesë në ndonjë arbitrazh tjetër, ndërmjetësim ose procedura të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të zhvilluara për konfliktin e mbrojtjes së të dhënave personale.

c) Çdo palë do të pajtohet me një vendim të gjykatës kompetente të vendit të themelimit të eksportuesit të të dhënave apo të autoritetit, i cili është përfundimtar dhe ndaj të cilit nuk mund të bëhet asnjë ankesë e mëtejshme.

VI. Përfundimi

a) Në rast se importuesi i të dhënave është në shkelje të detyrimeve të tij, sipas këtyre dispozitave, atëherë eksportuesi i të dhënave mund të pezullojë përkohësisht transferimin e të dhënave personale deri sa shkelja është riparuar ose kontrata është ndërprerë.

b) Në rast se:

1. Transferimi i të dhënave personale tek importuesi i të dhënave është pezulluar përkohësisht nga eksportuesi i të dhënave, për më shumë se një muaj, në përputhje me paragrafin (a);

2. Pajtueshmëria e importuesit të të dhënave me këto dispozita do ta vinte atë në shkelje të detyrimeve ligjore në vendin e importit;

3. Importuesi i të dhënave është në shkelje të vazhdueshme dhe të konsiderueshme të detyrimeve të mara përsipër në bazë të këtyre klauzolave.

4. Vendimi përfundimtar që nuk mund të apelohet në gjykatën kompetente të shtetit eksportues të të dhënave të vendit të themelimit të eksportuesit të të dhënave apo të rregullave të autoritetit që e ka pasur një shkelje të klauzolave nga importuesi apo eksportuesi i të dhënave; ose

5. Kërkesa e paraqitur për administrimin ose mbylljen e importuesit të të dhënave, qoftë në kapacitetin e tij personal ose të biznesit, kërkesa, e cila nuk është refuzuar brenda periudhës që është parashikuar në ligj për refuzimin e kërkesave të tilla, është bërë urdhri i mbylljes, është caktuar një administrator mbi të gjitha pasuritë; është emëruar një administrator i besuar i falimentit, nëse importuesi i të dhënave është individ; një marrëveshje me një kompani vullnetare është filluar, apo ndonjë rast ekuivalent që ndodh në çdo juridiksion, eksportuesi i të dhënave, pa paragjykuar të drejtat e tjera, të cilat ai mund të ketë ndaj importuesit të të dhënave, ka të drejtë të kufizojë këto dispozita, dhe në këtë rast duhet të informohet autoriteti kur kjo kërkohet. Në rastet e parashikuara nga pikat (1), (2) ose (4) më lartë, importuesi i të dhënave, gjithashtu, mund të kufizojë këto dispozita.

c) Secila palë mund të përfundojë këto dispozita, në qoftë se (1) pas çdo vendimi pozitiv të Komisionit lidhur me mjaftueshmërinë në bazë të nenit 25 (6) të direktivës 95/46/EC (ose ndonjë tekst të zëvendësuar) është nxjerrë në lidhje me një vend (apo një sektor të saj), për të cilin të dhënat janë transferuar dhe përpunuar nga importuesi i të dhënave, ose (2) direktiva 95/46/EC (ose ndonjë tekst i zëvendësuar) bëhet drejtpërdrejt i zbatueshëm në një vend të tillë.

ç) Palët bien dakord që përfundimi i këtyre neneve në çdo kohë, në asnjë rrethanë dhe për çfarëdo arsye (përveç për përfundimin sipas klauzolës VI (c) nuk i përjashton ato nga detyrimet dhe/ose kushtet klauzolat për sa u përket përpunimit të të dhënave personale të transferuara.

VII. Variacion i këtyre klauzolave

Palët nuk mund të modifikojnë këto dispozita vetëm për të rinovuar çdo informacion në aneksin B. Në këtë rast ata do të informojnë autoritetin kur kërkohet. Kjo nuk përjashton palët nga dispozita shtesë komerciale kur kërkohet.

VIII. Përshkrimi i transferimit

Detajet e transferimit dhe të dhënat personale janë të specifikuara në aneksin B. Palët pajtohen që aneksi B, mund të përmbajë informacione sekrete biznesi, të cilat ata nuk do t'ua zbulojnë palëve të treta, përveç kur kërkohet me ligj ose në përgjigje të një agjencie rregullatore ose kompetente të qeverisë, ose siç kërkohet sipas klauzolës I (d). Palët mund të ekzekutojnë anekset shtesë për të mbuluar transferime të tjera, të cilat do t'i paraqiten autoritetit kur kërkohet.

Aneksi B në alternativë, mund të hartohet për të mbuluar transfertat e shumta.
Datë: _____

PËR IMPORTUESIN E TË DHËNAVE PËR EKSPORTUESIN E TË DHËNAVE

ANEKSI A
PARIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

1. Kufizimi i qëllimit: të dhënat personale mund të përpunohen dhe të përdoren ose për komunikim të mëtejshëm, vetëm për qëllimet e përshkruara në aneksin B, ose pas autorizimit të subjektit të të dhënave. Të dhënat nuk duhet të mbahen për një afat më të gjatë për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar.

2. Cilësia e të dhënave dhe proporcionaliteti: të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme të jenë të përditësuara. Të dhënat personale duhet të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë transferuar dhe përpunohen më tej.

3. Transparenca: subjektet e të dhënave duhet të pajisen me informacionin e nevojshëm për të garantuar përpunimin e drejtë (informacione të tilla si rreth qëllimeve të përpunimit dhe për transferim), përveç, nëse ky informacion është dhënë nga eksportuesi i të dhënave.

4. Siguria dhe konfidencialiteti: kontrolluesit e të dhënave duhet të marrin masa organizative dhe teknike të sigurisë që të jenë të përshtatshme për rreziqet, të tilla si: kundër shkatërrimit aksidental ose të paligjshëm ose humbjes aksidentale, ndryshimit, përhapjes së paautorizuar ose aksesit, të paraqitur nga përpunimi. Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit të të dhënave, duke përfshirë një përpunues, nuk duhet të përpunojë të dhëna, përveç rastit kur lejohen nga kontrolluesi i të dhënave.

5. E drejta e aksesit, korrigjimit, heqjes dhe kundërshtimit: siç parashikohet në nenin 12 të direktivës 95/46/EC, subjektet e të dhënave duhet, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale të tretë, të jenë të pajisura me informacionin personal rreth atyre që një organizatë mban, me përjashtim të kërkesave që janë haptazi abuzive, të bazuara në intervale të paarsyeshme ose numri i tyre ose të përsëritura ose natyra sistematike, ose për të cilën aksesi nuk nevojitet sipas ligjit të vendit eksportues të të dhënave. Me kusht që autoriteti të ketë dhënë miratimin e tij paraprak, aksesi nuk mund të jepet kur ka të ngjarë të dëmtojnë seriozisht interesat e importuesit të të dhënave ose organizatave të tjera që kanë të bëjnë me importuesit e të dhënave dhe interesa të tilla nuk janë shkelur nga interesat për të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave. Burimet e të dhënave personale nuk duhet të identifikohen kur kjo nuk është e mundur nga përpjekjet e arsyeshme, ose kur të drejtat e personave të tjerë do të shkelen. Subjektet e të dhënave duhet të jenë në gjendje që informacionet personale rreth tyre t'i korrigjojnë, ndryshojnë ose fshijnë kur ato janë të pasakta ose janë përpunuar kundër këtyre parimeve. Nëse ka baza bindëse për të dyshuar legjitimitetin e kërkesës, organizata mund të kërkojë justifikime të mëtejshme para se të procedojë me korrigjimin, ndryshimin ose fshirjen. Njoftimi i ndonjë ndryshimi ose fshirjeje të palëve të treta, të cilave të dhënat u janë dhënë, nuk duhet bërë kur kjo përfshin një përpjekje joproporcionale. Një subjekt i të dhënave duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me faktin nëse ka bazë ligjore bindëse që lidhet me situatën e tij të veçantë. Barra e provës për çdo refuzim i mbetet importuesit të të dhënave, dhe subjekti i të dhënave mund të kundërshtojë një refuzim gjithmonë para autoritetit.

6. Të dhënat sensitive: importuesi i të dhënave do të marrë masa shtesë (p.sh. në lidhje me sigurinë) që janë të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave sensitive në përputhje me detyrimet e tij sipas klauzolës II.

7. Të dhënat e përdorura për qëllime të marketingut: Kur të dhënat janë përpunuar për

qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, procedurat efektive duhet të ekzistojnë për t'i lejuar subjektit të të dhënave në çdo kohë "të zgjedhë" që të dhënat e tij të mos përdoren për qëllime të tilla.

8. Automatike: "vendimi i automatizuar" është një vendim nga eksportuesi i të dhënave ose importuesi i të dhënave, i cili prodhon efekte juridike në lidhje me një subjekt të të dhënave ose dukshëm ndikon në një subjekt të të dhënave dhe që është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave personale, me qëllim që të vlerësojnë disa aspekte personale në lidhje me atë, si performancën e tij në punë, besueshmërinë, sjelljen etj. Importuesi i të dhënave nuk do të bëjë ndonjë vendim automatik në lidhje me subjektet e të dhënave, përveç kur:

a) 1. vendime të tilla janë bërë nga importuesi i të dhënave për të hyrë në një kontratë me subjektet e të dhënave; dhe

2. subjektit të të dhënave i është dhënë një mundësi për të diskutuar rezultatet e një vendimi përkatës të automatizuar me një përfaqësues të palëve të marrjes së vendimit të tillë, ose përndryshe për të bërë riprezantime këtyre palëve.

b) kur parashikohet ndryshe nga ligji i eksportuesit të të dhënave.

ANEKSI B
PËRSHKRIMI I TRANSFERTËS
(PËR T'U PLOTËSUAR NGA PALËT)

Subjektet e të dhënave

Transferimi i të dhënave personale ka të bëjë me kategoritë e mëposhtme të subjekteve të të dhënave:

.....
.....
.....
.....

Qëllimet e transferimit

Transferta bëhet për qëllimet e mëposhtme:

.....
.....
.....
.....

Kategoritë e të dhënave

Transferimi i të dhënave personale ka të bëjë me kategoritë e mëposhtme të të dhënave:

.....
.....
.....
.....

Marrësit

Transferimi i të dhënave personale mund t'u bëhet vetëm marrësve ose kategorive të mëposhtme të marrësve:

.....
.....
.....
.....

Të dhëna sensitive (nëse është i përshtatshëm)

Transferimi i të dhënave personale ka të bëjë me kategoritë e mëposhtme të të dhënave sensitive:

.....
.....

.....
.....

Informacion regjistrimi i mbrojtjes së të dhënave të eksportuesit të të dhënave
.....
.....
.....
.....……

Informacion i përdorshëm shtesë (kohëzgjatja e ruajtjes dhe informacionet e tjera të përshtatshme)

.....
.....
.....
.....

Pikat e kontaktit për nevoja të mbrojtjes së të dhënave

IMPORTUESI I TË DHËNAVE EKSPORTUESI I TË DHËNAVE